njavet Mysliman. Po të dihet se emri duhet të flitet plotsisht e jo të kastitet verbërisht, se këto krastitje emrin e shëmtojnë dhe nga kuptimi e ndryshojnë krejt. Për shëm.: emri (Bahtijar) ka kuptimin: Fatmir! po të krastitet: (Bato) ka kuptimin: fatkeq që batis! Për veç krastitjes lipset të mos përdorim edhe emra të tjera që s' ja u dijmë kuptimin. Po vetëm këtë pasqyrë, se pse emri (Zehrap) që e përdorin në ca vise ka kuptim uj i fëlliqur si farmaq. Emri (Qazibe) ka kuptimin: gënjeshtare! Pra maskëndaj lipset të mos përdorim emra pa pasqyrë se kuptim i atij emri i bën dëm edhe të zot. Kur të përdorim emra të mira, si pas kuptimit ec edhe fati i titullarit. Po të takosh ose po të udhtojsh me një njeri që ka emrin e mirë fatin e ke të mirë. Përndryshe fatin e ke ndryshe.

I miri Lajmëtar (Alejhis-Salaty vesselám) urdhronte: kur të më çoni një Delegat, zgjithni atë që ka emrin më të mirë që të bëhemi fatmirë. Fjal' e fundit: në të dy botë emri i mirë bën përshtypjet më të mira.

1. — Emrat e nalta të lajmëtarvet

1 Adem	2 Idris	3 Shiti
4 Nuhu	5 Hudi	6 Salih
7 Ibrahim	8 Ismail	9 Is-haku
10 Jakub	11 Jusuf	12 Ejjub
13 Shuajib	14 Musa	15 Harun
6 Daud	17 Sulejman	18 Dhylqifël

19 Iljas	20 Eljasa	21 Jonus
22 Zeqerijja	23 Jahja	25 Isa

26 Muhammed Mustafa (Alehimys-Salaty vesselma).

2. — Emrat e ndershëm të dijetarvet

1. — Abdull-llah: Kuptimi: rob' i thjeshtë i Zotit. Esht emri i babës të H. Pejgamberit dhe i shumë dijetarvet.

2. — Ataull-llah: Dhurat' e Zotit; emri i një dijetari që ka botue librën e naltë Hiqmet «Hiqemi Ata».

3. — Sejfullah: Pall' e Zotit Titull i ri i Halidvelitit që ka qënë trim komandant i H. Pejgamberit dhe me famë në gjithë botën i cili pushtoj Arebinë, edhe Greqinë e madhe.

4. — Fejzull-llah: Shij' e Zotit.

5. — Hajrullah: Hajir i Zotit.

6. — Habibull-llah: I dashur i Zotit.

7. — Emrull-llah: Emri i Zotit.

8. — Niëmetull-llah: Nimet i Zotit.

9. — Nurull-llah: Drit' e Zotit.

10. — Hiqmetull-llah: Hiqmet i Zotit.

11. — Muhjiddin: Përngjalls' i Dinit; (që ësht sulltan i gjith evlijavet).

12. — Behauddin: shevher i Dinit. (Mbret i evlijavet).

13. — Saláhuddin: Ndreqës' i besës. Emr' i një mbreti q' i bëri ballë gjith Evropës të bashkuar.

14. — Hajruddin: Hajir i besës.